

## **Dita Botërore e Dhuruesve të Gjakut**

Çdo 14 qershor, që prej vitit 2004, vendet në mbarë botën organizojnë Ditën Botërore të Dhuruesve të Gjakut. Kjo ditë shërben për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me nevojën për gjak të sigurt dhe nënproduktet e tij, si dhe për të falënderuar të gjithë dhuruesit që me këtë gjest shpëtojnë jetë.

**Transfuzioni i gjakut** dhe i nënprodukteve të tij ndihmon dhe shpëton miliona jetë çdo vit. Ai mund të ndihmojë pacientët në nevojë të rrisin jetëgjatësinë dhe cilësinë e saj. Depozitat e mjaftueshme të gjakut të sigurt dhe nënprodukteve të tij mund të ndihmojnë në zvogëlimin e shkallës së vdekjes.

Në shumë vende nuk ka një furnizim të mjaftueshëm me gjak të sigurt, dhe shërbimet e gjakut përballen me sfidën për të siguruar gjakun e nevojshëm, duke siguruar gjithashtu cilësinë dhe sigurinë e tij.

Furnizimi i mjaftueshëm mund të sigurohet vetëm përmes dhurimeve të rregullta dhe periodike. Qëllimi i OBSH-së është që në të gjitha vendet të sigurohet furnizimi me gjak të sigurt nga dhuruesit vullnetarë, deri në vitin 2020.

Dita Botërore e Dhuruesve të Gjakut është një mundësi më shumë për të promovuar në nivel kombëtar dhe botëror nevojën për gjak të sigurt dhe nënproduktet e tij.